

# Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar

## MESAZH NGA DREJTUESIT E PROGRAMIT AASF

Këto ditë kanë qenë shumë të vështira për të gjithë ne. Kjo sfidë e jashtëzakonshme që vjen nga pandemia COVID-19 është kriza më e madhe shëndetësore që bota ka njohur ndonjëherë prej një shekulli. Si pasojë, edhe projektet zhvillimore si AASF kanë nisur të përshtaten me situatën e re.

Meqenëse të gjitha aktivitetet fizike që kërkojnë kontakt të drejtpërdrejtë me Institucionet Financiare Partnere (PFI) apo grupe të tjera interesi (trajtime, seminare, aktivitete) janë ndaluar deri në një njoftim të dytë, jemi duke punuar intensivisht në ofrimin e mbështetjes së adaptuar përmes kanaleve digjitale.

Për ne në AASF, shëndeti dhe mirëqenia e ekspertëve dhe partnerëve tanë ka përparësi absolute. Bashkë me ekipin e Programit, po diskutojmë mënyrat më të mira dhe përdorimin e kanaleve më adekuate të platformave online për të vazhduar punën, duke përbushur përgjegjësitë tona sociale përmes distancimit fizik.

Pasi kjo krizë goditi edhe Shqipërinë, AASF rifokusoi aktivitetet e saj të asistencës teknike duke bërë të mundur finalizimin e atyre produkteve që janë tashmë në proces, siç janë mjetet digjitale për vlerësime të agro-klientëve, publikimet dhe studimet e sektorit teknik përkatës, për të qënë të gatshëm të asistojnë PFI-të dhe palët e interesuara sa më shpejt pasi të ketë kaluar kjo situatë. Paralelisht, jemi duke vazhduar punën në mbështetje të rritjes së kapaciteteve me partnerët tanë duke shfrytëzuar organizimin e Webinareve dhe trajnimeve elektronike.

Në të njëjtën kohë, jemi duke përdorur platformat e rrjeteve sociale për të komunikuar me grupet e interesit dhe përfituesit tanë. Një nga këto platforma është gjithashtu faqja zyrtare në LinkedIn Albania Agribusiness Support Facility (AASF) ku ju ftojmë të na ndiqni dhe të qëndroni në komunikim të vazhdueshëm me ne.

Ndërsa projekti ynë do të vazhdojë punën, ekipi AASF ju fton të ndani me ne inputet dhe rekomandimet tuaja në funksion të përmirësimit sektorial. Ndërkohë, po ju prezantojmë edicionin tonë të ri të Buletinit të Programit, ku do të gjeni aktivitetet dhe ngjarjet kryesore të AASF të këtij katërmujori të parë të vitit 2020.

Falënderojmë të gjithë partnerët tanë për angazhimin e lartë të treguar gjatë kësaj periudhe duke vazhduar të punojnë me ne pavarësisht kësaj situatë të paparashikuar. Falenderime të veçanta shkojnë edhe për fermerët shqiptarë dhe agrobizneset në përgjithësi, të cilët edhe pse të rrezikuar nga virusi mbajnë të pandarë zinxhirin e furnizimit me ushqim për qytetarët dhe familjet në nevojë në këtë moment krize.

AASF është mirënjohës dhe ju siguron që do të bëjë më të mirën për të mbështetur ekipet dhe klientët e tij për të kaluar këtë situatë të vështirë pandemie. Ne kemi besimin se këtë stuhë do ta përballojmë së bashku! Urojmë për ju dhe familjet tuaja sa më shumë durim dhe qetësi për javët e ardhshme.

Qëndroni të sigurt dhe do të shihemi së shpejti!

**Frieder Woehrmann**  
Drejtor i Programit, AASF

**Adela Leka**  
Zëvendësdrejtoreshë e Programit, AASF

## KOMPONENTËT KRYESOR TË PROJEKTIT

### Risku i parë i humbjeve ("FLRC")

është një mekanizëm për rritjen e kreditimit të siguruar nga Qeveria e Shqipërisë, duke mbuluar 20% të humbjeve të shumës totale të nën-kredive të financuara me të ardhurat nga Linja e Kredisë së Agrobiznesit ose nga Shpërndarja e Riskut.



### Linjat e kreditimit të Agrobiznesit

si linjat e kredisë jo të sigurta për Institucionet Financiare Partnere në Shqipëri në financimin e subjekteve të agrobiznesit për investime afatmesme dhe afatgjata.

### Lehtësitë e shpërndarjes së riskut të Agrobiznesit

në pjesëmarrje në portofolin e pafinancuar, si një instrument i cili mbulon deri në 50% të shumës totale të papaguar të portofolit të nën-kredive të Agrobiznesit.



### Asistencë teknike:

- Ndërtimi i kapaciteteve të Institucioneve Financiare Pjesëmarrëse.
- Asistencë teknike të specifikuar për sektorin e agrobiznesit.

## 01 Aktivitete të rjetëzimit

Në fillim të muajit Mars, AASF dhe Bashkia e Malësisë së Madhe organizuan një aktivitet ndërmjetësues agrobiznesi në ambientet e bashkisë së qytetit. Malësia e Madhe ka një traditë të fortë në prodhimin dhe eksportimin e Bimëve Medicinale dhe Aromatike (BMA). BMA-të janë një nga produktet kryesore agrorshqimore që trajtohen për qëllime eksporti. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte informimi nga ana e ekspertëve të AASF të fermerëve dhe agrobizneseve shqiptare për mundësitë e aksesit në financa përmes Programit AASF dhe granteve plotësuese si IPARD dhe skemave kombëtare të granteve. Ekspertët e AASF prezantuan ofertat e Institucioneve Financiare Partnere për klientët e bujqësisë dhe moderuan një



diskutim të gjallë se si agrobizneset mund të aksesojnë në shërbimet ekzistuese dhe produktet nga këto institucione. Për shkak të kërkesës së lartë ndërkombëtare për BMA, sektori kërkon investime më të mëdha me qëllim rritjen e kapaciteteve në funksion të përballimit të kërkesës që vjen nga eksporti.



Citim nga ekspertët e AASF

*"Sot fermerët dhe agrobizneset kërkojnë fonde shtesë përveç granteve dhe asistencës teknike. Pjesa më e madhe e tyre nuk kanë kolateral të mjaftueshëm për t'u financuar nga Institucionet Financiare. Kjo është arsyeja pse mekanizmat e ndarjes së riskut të AASF mund të mbulojnë një pjesë të rrezikut të lidhur me kolateralin për të rritur investimet cilësore dhe efikase në bujqësi. AASF ofron mjete të ndryshme mbështetëse për sektorin e bujqësisë dhe partnerët e tjerë në sektor."*

Zj. Adela Leka,  
Zëvendësdrejtore dhe e Programit të AASF

## 02 Trajnine dhe seminare

Në Janar, AASF mbështeti seminarin me temë "Ndërgjegjësimi i aktorëve për diversifikimin e aktiviteteve në Bashkinë Korçë" të mbajtur në qytetin e Korçës. Aktiviteti u organizua nga Programi i Mbështetjes së Shoqatës Rurale (RASP), në kuadër të projektit "Rritja e Kapacitetit të Fermerëve dhe Palëve të tjera të interesit në Diversifikimin e Aktiviteteve Rurale", financuar nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara (FAO).

Seminari kishte për qëllim rritjen e vetëdijes të fermerëve dhe agrobizneseve rurale për nevojën e diversifikimit të fermave dhe produkteve. Më tej, identifikimi i nevojave teknike dhe financiare të fermerëve ishte një tjetër aspekt i takimit.

Agrobizneset e pranishme nga ky rajon u prezantuan me Programin AASF, si një mundësi për të patur akses në mbështetje financiare dhe asistencë teknike. Vëmendje e veçantë iu kushtua ndërthurjes së skemave kombëtare të granteve dhe IPARD me mekanizmat e ndarjes së rrezikut të AASF përmes Institucioneve Financiare Partnere.




## 03 Aktivitete promovuese

Ekspertët e Programit prezantuan kartat informative të AASF mbi "Mekanizmat për zbutjen e rrezikut" gjatë Workshop-it Ndërkombëtar: "Zhvillimet e sektorit të bujqësisë - midis ndryshimit të klimës dhe integritit në BE" të mbajtur në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA) të Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) gjatë muajit shkurt.

"Mekanizmat për zbutjen e rrezikut" janë një grup prej nëntë kartash informative për produktet kryesore bujqësore, të cilat ofrojnë një përmbledhje të shkurtër në lidhje me fakte nga tregu për bankat dhe agrobizneset shqiptare. Ato ofrojnë një panoramë strategjike mbi

mekanizmat e zbutjes së riskut sektorial që mund të ndikojnë potencialisht në produkte specifike.

Aktiviteti u organizua nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me mbështetjen e Programit AASF. Si pjesëmarrës, AASF mirëpriti Zëvendësministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Rektorin e UBT dhe Dekanin e FEA, profesorët, studentët dhe përfaqësuesit e Institucioneve Financiare dhe kompanive të sigurimeve.



Citim nga grupet e interesit

*"Ne kemi kapacitetin për të bërë punë të mira që do t'i paraprijnë zhvillimit të bujqësisë dhe sfidave të saj. Universiteti i Bujqësisë në Tiranë është një vlerë e shtuar për Ministrinë e Bujqësisë dhe më gjerë. Gjithashtu, le të promovojmë edhe bashkëpunimin midis akademisë dhe institucioneve financiare me qëllim zhvillimin e sektorit bujqësor"*

Prof. Dr. Bahri Musabelliu,  
Rektor i Universitetit Bujqësor të Tiranës.



## Daljet Mediatike

Në përgjithësi, agroturizmi përcaktohet gjerësisht si një lloj aktiviteti agro-kulturor që tërheq njerëzit dhe i inkurajon ata të vizitojnë një fermë ose një vend tjetër larg qendrave urbane.

Shqipëria është një vend me bazë bujqësore me vendndodhje të veçantë gjeografike, peisazhe të jashtëzakonshme, e pasur me kulinari dhe gastronomi. Kombinuar me një traditë të shkëlqyer për



mikpritjen, Shqipëria ka një potencial të madh për zhvillimin e agroturizmit.

Ekspert i Lartë i Agrobiznesit, Ilir Pilku, është bërë pjesë e disa programeve televizive

për të diskutuar mundësitë dhe sfidat e këtij sektori në Shqipëri. Për më shumë informacion, ju lutemi na ndiqni në faqen tonë në LinkedIn: Albania Agribusiness Support Facility (AASF)

## PUBLIKIME

AASF ka publikuar së fundmi një studim gjithëpërfshirës mbi "Agroturizmin në Shqipëri: Potencialet e zhvillimit dhe nevojat financiare". Studimi ka për synim të inkurajojë Insituticionet Financiare Partnere (PFI) dhe sektorin financiar në përgjithësi, të risë financimin në Agroturizëm. AASF mund të mbështesë PFI-të në zhvillimin e strategjive të posaçme të financimit me produkte dhe paketa të përshtatura për të përbushur nevojat e financimit të sektorit. Ky studim ofron informacione mbi mundësitë e zhvillimit të agroturizmit në Shqipëri. Ai orienton gjithashtu nevojat e sektorit për financim me qëllim realizimin e investimeve adekuete.

Më konkretisht, dokumenti hedh dritë mbi potencialet ekzistuese në sektorin e Agroturizmit, duke u përqëndruar në strategji të ndryshme publike, zhvillime të fundit, stimuj fiskal dhe financiar dhe një analizë SWOT të sektorit. Për më tepër, studimi paraqet një përpunim të kërkesave për kapital dhe karakteristikave të furnizimit për industrinë e Agroturizmit për të ofruar rekomandime të dobishme për PFI-të.

Për të mbështetur më tej sektorin dhe për të siguruar informacione për PFI-të, AASF ka përfunduar gjithashtu një studim mbështetës sektorial në lidhje me Zinxhirët e Vlerës së Bujqësisë në Shqipëri. Gjetjet e studimit nënkuptojnë se qasja e financimit të zinxhirit të vlerës mund të jetë një mënyrë inovative e financimit të sektorit bujqësor - në këtë rast, për sektorin e qumështit. Studimi duhet të mbështesë procesin e vendimmarrjes së institucioneve financiare në financimin e klientëve bujqësorë. Financimi i zinxhirit të vlerës përipiqet të shikojë të gjithë zinxhirin e vlerës bujqësore nga një këndvështrim nga lart.



## Sektori i agroturizmit në Shqipëri: Potencialet për zhvillim dhe nevojat financiare

Studimi i Financimit të Zinxhirit të Vlerës së AASF mbështet institucionet financiare në hartimin e shërbimeve financiare dhe produkteve përmes marrëveshjeve trepalëshe. Qasja e zinxhirit të vlerës lejon një ndarje më të mirë të klientëve dhe krijimin e Indikatorëve Kyç të Performancës me fokus në rritjen e efikasitetit të transaksioneve dhe uljen e kostos. Financimi i zinxhirit të vlerës së bujqësisë rrit procesin e vlerësimit financiar duke përdorur Kartat Teknologjike të AASF dhe paracaktuar KPI-të. Ai gjithashtu lehtëson kontrollin e rreptë të përdorimit të fondeve dhe monitorimin e zgjeruar të ripagimit përmes transaksioneve brenda llogarive bankare të institucionit.

Për të patur akses në këto studime, lutemi vizitoni faqen tonë të internetit: [www.aasf.com.al](http://www.aasf.com.al)



### Citim nga Qeveria Shqiptare

*"Është misioni juaj, që bashkë me ne, të orientojmë drejt zhvillimin e bujqësisë shqiptare. Bujqësia sot nuk mbahet më vetëm për patriotizëm. Sot jemi në treg me konkurrencë dhe do të duhet të prodhojmë të ardhura."*

**Z. Dhimitër Kote,**  
Zëvendësiministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

**Otp Bank**

OTP Bank si një lojtar dominues bankar në Hungari dhe rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore ofron shërbime financiare me cilësi të lartë për më shumë se 18.5 milion klientë privatë dhe korporata në nëntë vende përmes pothuajse 1500 degëve të saj, rrjeteve të agjentëve, 3900 ATM-ve, kanaleve të internetit dhe elektronike. Zhvillimi dhe zgjerimi i vazhdueshëm i OTP Bank ka kontribuar ndjeshëm në funksionimin e suksesshëm dhe efikas të grupit bankar, i cili ofron shërbime me cilësi të lartë si për klientët me pakicë ashtu edhe për institucionet. Megjithë konkurrencën e fortë, pozicioni i tregut të OTP Bank është i qëndrueshëm në disa segmente, si dhe përsa i përket përfitimit dhe stabilitetit, banka i takon vijës evropiane. Megjithëse OTP Bank është e re në tregun shqiptar, sektori i agrobiznesit është një nga segmentet kryesore të synuara për mbështetjen e tyre financiare.

Link: <https://otpbank.al/>

**Intesa San Paolo**

Intesa Sanpaolo Bank është një nga bankat më të mëdha në vend që ofron një gamë të gjerë zgjidhjesh financiare, produkte dhe shërbime novatore për klientët e korporatave, klientët privatë institucionalë dhe me të ardhura të larta, si dhe bizneset e vogla dhe të mesme dhe klientët individualë. Intesa Sanpaolo Bank Albania ka një rrjet prej 35 degësh në qytete të ndryshme të vendit dhe po zgjerohet më tej strategjikisht në të gjithë Shqipërinë. Risia dhe përsosmëria e shërbimeve në Intesa Sanpaolo Bank Albania janë frymëzuar nga klientët e saj. Një nga strategjitë e Bankës Intesa Sanpaolo në Shqipëri është zgjerimi i portofolit të saj në agrobiznes, duke mbështetur posaçërisht bizneset e vogla dhe fermerët me zgjidhje financiare të përshtatura.

Link: <https://www.intesasanpaolobank.al/>

**Raiffeisen Bank**

Raiffeisen Bank është një nga bankat më të mëdha në vend dhe gjatë 14 viteve të fundit ka shndërruar plotësisht Bankën e vjetër të Shtetit në një bankë me shërbim të plotë që shërben për të gjithë sektorët e biznesit dhe tregjet private individuale. Banka ka një gamë produktesh, procesesh, sistemesh dhe një infrastrukture degësh që krahasohet në mënyrë të favorshme me standardet evropiane të shekullit XX. Raiffeisen Bank ofron gamën e plotë të produkteve dhe shërbimeve bankare në 4 sektorët kryesorë të biznesit në të cilët operon - individë privatë, mikro biznes, biznes të vogël dhe biznes korporative dhe u shërben më shumë se 800,000 klientëve. Raiffeisen Bank mbështet agrobiznesin dhe fermerët në çdo aktivitet të biznesit të tyre përkundër madhësisë dhe pozicionit të tij në industri. Si çdo hua tjetër, edhe kjo është e strukturuar duke u bazuar në ciklin e biznesit bujqësor.

Link: <https://www.raiffeisen.al/>

**Fondi Besa**

Fondi Besa, me 80 zyra në të gjithë Shqipërinë, synon të jetë i pranishëm aty ku ka nevojë për zhvillim, duke ofruar mundësi aksesit për mijëra njerëz, duke i mbështetur ata me shërbime financiare, duke krijuar lidhje midis klientëve dhe mundësive dhe duke kontribuar në zhvillimin më të mirë ekonomik të vendit.

Link: <https://fondibesa.com/>

**Pro Credit Bank**

ProCredit Bank është një bankë tregtare e orientuar drejt zhvillimit. Banka ofron shërbim të shkëlqyeshëm për klientët, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe për individët privatë që kanë aftësinë për të kursyer dhe që preferojnë të kryejnë veprimet e tyre bankare përmes kanaleve elektronike. Fokusi i tyre është tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, pasi janë të bindur se këto biznese krijojnë vende pune dhe japin një kontribut jetik për ekonominë në të cilat operojnë. Një nga strategjitë kryesore për huadhënien është të mbështesni klientët që merren me prodhim dhe bujqësi.

Linku: <https://www.procreditbank.com.al/>

**AZHBR**

Agjensia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (ARDA) është një agjenci kombëtare shtetërore që synon të mbështesë sipërmarrësit shqiptarë në sektorin e bujqësisë dhe ushqimit, duke përgatitur institucionin të përfitojë nga fondet e BE-së dhe donatorëve të tjerë. ARDA po mbështet sektorin drejt ristrukturimit, modernizimit dhe specializimit në produkte dhe tregje specifike bazuar në avantazhet konkurruese të vendit. AASF është që prej vitit 2016 duke bashkëpunuar me ARDA për të mbështetur fermerët dhe agrobiznesin në Shqipëri përmes ndihmës teknike dhe mbështetjes financiare.

<http://azhbr.gov.al>

**AASF**

Rr. Andon Zako Çajupi, No.7, Tiranë, Albania

(T): +355 69 294 1513

(E): [info@aaaf.com.al](mailto:info@aaaf.com.al)

(W): [www.aaaf.com.al](http://www.aaaf.com.al)

Na ndiqni në :

The Albania Agribusiness Support Facility (AASF)